

SKEDË INFORMUESE

Thirrjen e hapur për projekte për bashkitë "Citizens' Engagement and Participation" (CERV-2025-CITIZENS-CIV) nën Programin CERV

Programi Citizens, Equality, Rights and Values (CERV) është një program financimi i Bashkimit Evropian që synon të promovojë të drejtat themelore, demokracinë, barazinë dhe vlerat në vendet anëtare. Ky program mbështet financiarisht me grante projektet që luftojnë diskriminimin, promovojnë barazinë gjinore, mbrojnë të drejtat e njeriut dhe forcojnë pjesëmarrjen demokratike. Përmes tij, synohet ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe respektimi i vlerave të përbashkëta evropiane. Programi CERV është i ndarë në 4 komponentë: "Citizens", "Equality", "Rights" dhe "Union Values". Shqipëria është pjesë e programit CERV vetëm në komponentët "Citizens", "Equality" dhe "Rights".

Synimi i thirrjes:

Thirrja CERV-2025-CITIZENS-CIV mbështet projekte ndërkombëtare që angazhojnë drejtpërdrejt qytetarët në politikat e BE-së. Qytetarëve do t'u ofrohet mundësia që të marrin pjesë aktive në proceset demokratike dhe të ndajnë publikisht pikëpamjet e tyre. Projektet synojnë të fuqizojnë qytetarët, veçanërisht të rinjtë, për të kuptuar dhe kontribuar në politikëbërjen e BE-së.

Prioritetet e thirrjes:

- Promovimi i shkëmbimeve mbi prioritetet dhe sfidat e politikave të ardhshme të Bashkimit Evropian.
- Veprimet kundër dezinformimit, manipulimit të informacionit dhe ndërhyrjes në debatin demokratik.
- Promovimi i angazhimit aktiv të qytetarëve dhe pjesëmarrjes demokratike.

Rezultatet e pritshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat dhe vlerat e BE-së dhe rritja e angazhimit të tyre në shoqëri dhe me BE-në;
- Mundësi të zgjeruara për qytetarët për të shprehur dhe për t'i bërë të ditur pikëpamjet e tyre për llojin e Evropës që duan dhe për të përshkruar vizionin e tyre afatgjatë për të ardhmen e integritimit evropian;
- Përmirësim i njohuri dhe kuptimit nga qytetarët për institucionet dhe politikat e BE-së, ashtu si dhe për arritjet dhe përfitimet e BE-së;
- Rritja e fuqisë së qytetarëve për t'u përfshirë në vendimmarrje nga niveli vendor deri në atë të BE-së;
- Rritja e fuqisë së qytetarëve për të bërë zërin e tyre të dëgjohej nga autoritetet përkatëse politike dhe vendimmarrësit, duke i ndihmuar ata të kenë ndikim në praktikë;

- Rritja e pjesëmarrjes aktive të njerëzve me prejardhje të ndryshme në procesin e bërjes së politikave të BE-së dhe si rrjedhim rritja e kontributit në jetën demokratike dhe qytetare të Bashkimit Evropian;
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për situatën, elasticiteti dhe gatishmëria për të luftuar dezinformimin dhe manipulimin e informacionit;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të qytetarëve për SLAPP-të dhe një mjedis më i sigurt dhe më i favorshëm për gazetarinë
- Forcimi i pjesëmarrjes demokratike, me fokus të veçantë në përfshirjen e të rinjve dhe të moshuarve, grave, qytetarëve të lëvizshëm të BE-së dhe personave me aftësi të kufizuara, dhe në arritjen e atyre qytetarëve që nuk janë aktivë në pjesëmarrjen qytetare në jetën e tyre të përditshme.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Aplikuesit duhet të jenë entitete ligjore (publike ose private) ose organizata ndërkombëtare.
- Konsorciumet duhet të përbëhen nga të paktën **dy aplikantë nga dy vende të ndryshme të pranueshme.**

Aktivitete të pranueshme:

- Organizimi i debateve publike, punëtorive ose konferencave në fusha specifike të politikave të BE-së.
- Përdorimi i platformave në internet ose fushatave të mediave sociale për të përfshirë qytetarët në diskutime mbi politikat dhe prioritetet e BE-së.
- Zhvillimi i materialeve edukative ose mjeteve për të angazhuar dhe ndihmuar qytetarët të kuptojnë politikat e BE-së dhe ndikimin e tyre në jetën e përditshme.
- Lehtësimi i shkëmbimeve ndërmjet qytetarëve nga vende të ndryshme të BE-së për të shkëmbyer përvoja dhe perspektiva mbi politikat e BE-së.
- Angazhimi i qytetarëve në zhvillimin dhe shpërndarjen e mjeteve, platformave të shkëmbimit të njohurive dhe burimeve për t'i ndihmuar qytetarët të parandalojnë, zbulojnë dhe zhvlerësojnë dezinformimin dhe manipulimin e informacionit.
- Organizimi i programeve të trajnimit të shkrim-leximit mediatik dhe/ose zbatimi i mjeteve për qytetarët, veçanërisht për të rinjtë, duke i ndihmuar ata të vlerësojnë në mënyrë kritike online informacionin.
- Angazhimi i qytetarëve në fushata ndërgjegjësimi publik për të nxjerrë në pah rreziqet e dezinformimit dhe manipulimit të informacionit dhe inkurajimin e përdorimit të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale.
- Organizimi i trajnimeve, shkëmbimet e praktikave më të mira, angazhimi i aktorëve përkatës në raportimin dhe monitorimin e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs) dhe veprimeve në mbështetje të mediave të pavarura dhe gazetarëve kundër SLAPP-ve.
- Zhvillimi dhe lehtësimi i iniciativave të udhëhequra nga qytetarët përmes debateve, shprehjes së mendimeve dhe aktiviteteve të tjera të angazhimit të qytetarëve.

- Zhvillimi, zbatimi dhe shpërndarja e programeve ose materialeve arsimore për t'i mësuar qytetarët për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetarë të BE-së dhe se si të marrin pjesë në proceset demokratike.
- Mbështetja e proceseve zgjedhore të lira, të drejta dhe gjithëpërfshirëse duke kryer fushata ndërgjegjësimi, programe angazhimi, seminare, konferenca.
- Mbështetja e zhvillimit të mjeteve dhe platformave për të lehtësuar angazhimin e qytetarëve dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.
- Lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve publike, duke përfshirë këshilltarët vendorë, për të promovuar demokracinë pjesëmarrëse.

Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

Buxheti total i thirrjes është **33,000,000 EUR**, i ndarë sipas prioriteteve:

- Prioriteti 1: **12,500,000 EUR**.
- Prioriteti 2: **8,000,000 EUR**.
- Prioriteti 3: **12,500,000 EUR**.

Kohëzgjatja e projekteve normalisht duhet të jetë nga 12 deri në 24 muaj. Zgjatjet e kohëzgjatjes janë të mundshme, nëse justifikohen siç duhet.

Buxheti për secilin projekt-propozim:

- Shuma minimale e grantit: **75,000 EUR**.
- Shuma maksimale e grantit: Pa limit (po jo më shumë se sa është caktuar për prioritetin e zgjedhur).

Si bëhet aplikimi:

- Aplikimet dorëzohen përmes Portalit të Financimit dhe Tenderëve të BE-së.
- Kërkohen formularë të plotësuar online dhe dokumente mbështetëse (si CV, përshkrimi i projektit dhe buxheti).

Kur është afati i fundit:

- Hapja e thirrjes: **15 Janar 2025**.
- Afati i fundit për aplikim: **29 Prill 2025**, ora 17:00 (ora e Brukselit).

Nëse keni pyetje ose keni nevojë për ndihmë shtesë, mbetemi në kontakt!

Linku i thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2025-CITIZENS-CIV?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate&isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43251589>